

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E ENJTE 12 MAJ 2022

Të nderuar kolegë,

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është krijuar në vitin 2002 dhe kryen aktivitetin e saj në bazë të ligjit nr. 53/14, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” dhe administron në skemën e sigurimit të depozitave të gjitha depozitat me afat, depozitat pa afat, llogaritë rrjedhëse dhe llogaritë e kursimit që janë në banka dhe në shoqëritë e kursim-kredive në territorin e Republikës së Shqipërisë. Anëtarësimi i bankave dhe i shoqërive të kursim-kredive është një skemë e detyrueshme, me përjashtim të degëve të huaja, që e kanë sigurimin në vendin e tyre të origjinës në rastet kur ai sigurim është më i lartë se ai që ofrohet nga FSDK-ja.

Duhet të theksojmë se depozituesit, pra të gjithë individët ose shoqëritë tregtare, nuk kanë asnjë kosto për sigurimin e depozitave të tyre, janë bankat dhe shoqëritë e kursim-kredive, të cilat kanë detyrimin ligjor që ta paguajnë atë. Thuhet se sa më i lartë të jetë risku që sjellin bankat, aq më i lartë është edhe kontributi që ata duhet të paguajnë në këto fonde. Qëndrueshmëria e sistemit bankar është faktori kryesor që ndikon në pozicionin e likuiditetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Kjo Agjenci, në bazë të informacionit të marrë nga Banka e Shqipërisë, vlerëson vazhdimisht qëndrueshmërinë e sistemit bankar, në mënyrë që të parashikojë në vazhdimësi detyrimin e saj ndaj depozituesve. Sipas raportit të fundit për stabilitetin financiar, Banka e Shqipërisë vlerëson se sektori bankar ka zgjeruar veprimtarinë gjatë vitit 2021, nga njëra anë, ose siç ata e quajnë “pasiv”, në rritjen e detyrimin të depozitave dhe, nga ana tjetër, ose në aktiv, në rritjen e investimeve në tituj.

Gjithashtu, indeksi i sistemit bankar ka një përmirësim të lehtë në raport me vitin 2022. Bankat dhe SHKK-të kanë detyrimin ligjor që të informojnë në detaje të gjithë depozituesit lidhur me mbrojtjen e depozitave të tyre. ASD-ja siguron depozitat e sigurueshme në çdo bankë dhe në SHKK, në banka e siguron deri në nivelin e 2,5 milionë lekëve të rinj për depozitues, ndërsa për SHKK-të deri në 2 milionë lekë. Kanë qenë pjesë e sistemit të sigurimit të depozitave gjatë vitit 2021 12 banka dhe 9 shoqëri kursim-krediti. Përfituesit nga kjo skemë e kompensimit të depozitave janë të gjithë depozituesit në banka dhe në shoqëritë e kursimkreditit, siç mund të jenë individë, tregtarë dhe shoqëri tregtare,

rezidentë ose jorezidentë, shqiptarë ose të huaj, që kanë një depozitë në lekë ose në monedhë të huaj në këto dy institucione.

Depozitat në valutë janë të siguruara deri në të njëjtën shumë me ekuivalentin, ku si ekuivalent përdoret kursi i datës 31.12 i Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2021 totali i depozitave në sistemin bankar ka pasur një trend rritës, siç u tha edhe në raport, si në banka, ashtu edhe në SHKK. Të ardhurat që ndikojnë në ASD vijnë nga primet dhe nga administrimi i mjeteve financiare. Primet janë të gjitha vlerat që paguajnë pjesëmarrësit, bankat dhe SHKK-të, ndërsa mjetet financiare janë të gjitha ato investime në letra me vlerë të qeverisë shqiptare në depozita 1-javore, ose gjendje në llogari pranë Bankës Shqipërisë, ose pranë bankës kujdestare, që është Raiffeisen Bank.

Vlen për t'u theksuar puna e mirë ASD-së, kontrolli dhe testet që ata bëjnë në mënyrë të vazhdueshme lidhur me të gjithë operatorët, pra me 12 bankat dhe 9 shoqëritë në vazhdimësi, si dhe marrëveshjet dhe marrëdhëniet që ata kanë me të gjithë homologët e tyre në nivel ndërkombëtar. Puna e mirë është vlerësuar edhe nga audituesit e pavarur, të cilët kanë bërë auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2021 të ASD-së, nuk është e nevojshme të përmend emrin, ku, si rrallë herë, në auditime të tilla për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave është dhënë një opinion pa rezerva, pra është dhënë një opinion, i cili paraqet në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar, pasqyrën e performancës dhe flukset e parasë në përputhje me SNRF-të, standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Konkretisht, në opinion thuhet se shifrat që janë paraqitur nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave janë shifra që paraqesin realitetin. Agjencia është kujdesur që, edhe në portofolin e saj instrumentet likuide t'i ketë mbi nivelin e kërkuar, ku për investimet në lekë ka një nivel jo më pak se 10% të portofolit dhe është 17,32%, në raport me 14,3% që ka qenë në vitin 2020, ndërsa për monedhën e huaj duhet të jetë jo më pak se 5% dhe është 10,68%, nga 8,2% që ka qenë në vitin 2021. Unë nuk dola t'i bëj elozhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, por bëra një rezymë të asaj që unë kam parë, asaj që është paraqitur në raport dhe analizës që i kam bërë vetë pasqyrave financiare të vitit 2021. Patjetër duhet që të tregoj kujdes, sepse, si rezultat i krizës, edhe sistemi bankar në një moment të caktuar mund të paraqesë probleme. Por e gjithë situata e paraqitur deri më sot nga të gjitha institucionet përgjegjëse rezulton e shëndetshme.

Një element tjetër që Agjencia e Sigurimit të Depozitave duhet ketë në konsideratë, lidhet me kufizimet që duhen vendosur kur njerëzit dynden në sportelet e bankave për të bërë tërheqje se kanë frikë, por edhe kjo është e rregulluar nga ASD-ja, e cila është kujdesur që kjo gjë të mos ndodhë. Në lidhje me

legjislacionin, unë mund të bëja edhe disa sugjerime, sepse ne flasim për depozita, që plotësojnë kushtin për të qenë të siguruara dhe për depozita që nuk plotësojnë kushtin për të qenë të siguruara. Tek ato depozita që nuk e plotësojnë kushtin për të qenë të siguruara, mund të ketë vend për ndonjë ndryshim, për të parë edhe natyrën e depozitave, por kjo është një pikë që ne e kemi diskutuar me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave dhe në vijim do të shihet mundësia për të bërë një përmirësim ligjor. Faleminderit!